


KONTRATE DHURIMI
KUOTASH TË KAPITALIT



Ne Tirane sot me date 01/06/2003 (dymijë e tre) përpilohet nga unë
Noterja Lindita Lleshi, regjistruar në Dhomën e Noterëve Tiranë, kjo kontratë dhurim
kuotash të kapitalit midis paleve:

DHURUESA:

1. MIRGEN DHIMA, i biri i Sotirit, lindur më 1977, banues në Tiranë, Lagjia "F. Shiroka" Nr. 22, me pashaportë nr. 1692353,
2. BRUNILDA MUHA, e bija e Fuatit, lindur më 1979, banuese në Tiranë, Rruga Thanas Ziko, P. 65/2/1/25, me pashaportë nr. 1823546.

PRANUES TË DHURIMIT:

1. ENKELEJDA KUMARAKU, e bija e Andreas, me datelindje 31.12.1975, banuese ne Tiranë, Rr. Vasil Shanto, Pall. i Ri, me pashaportë nr. 1148144
2. ANDREA KUMARAKU, i biri i Naunit, lindur më 1946, banues në Tiranë, Rr. Vasil Shanto, Pall. i Ri.
3. ERMELA ZAIMI, e bija e Pëllumbit, lindur në Vlorë, banuese në Tiranë, me pashaportë nr. 0406109.
4. ERJON PRENDI, lindur më 1979, banues në Tiranë, me pashaportë nr. 9922-92 M.T.

Palët e mësipërme janë madhorë me zotësi të plotë për të vepruar, të cilat, bazuar ne ligjin 7638 datë 19. 11. 1992 "Per Shoqërite Tregëtare" palet bien dakord sa vijon:

Me vendimin Nr. 1 datë 21.08.2003 te ortakeve të Shoqërisë "MEDIA J-7" Sh.p.k. është vendosur dhurimin e 60% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë baraz me 60.000 lekë nga Ortakët që largohen Mirgen Dhima dhe Brunilda Muha (secili nga 30%) në favor të ortakëve të rinj që pranohen në Shoqëri Enkelejda Kumaraku (40%), Andrea Kumaraku (10%), Ermela Zaimi (5%) dhe Erjon Prendi (5%).

Enkelejda Kumaraku pranon dhurimin e 30%, baraz me 30.000 lekë, të kuotave të kapitalit të ortakut që largohet Mirgen Dhima, si dhe 10%, baraz me 10.000 lekë të ortakut tjetër që largohet Brunilda Muha. Andrea Kumaraku pranon 10%, baraz me 10.000 lekë, të kuotave të kapitalit të ortakut që largohet Brunilda Muha, dhe Ermela Zaimi dhe Erjon Prendi pranojnë secili nga 5%, baraz me 5.000 lekë, të kuotave të kapitalit themeltar të ortakut të largohet Brunilda Muha.